

L I G J
Nr. 9514, datë 18.4.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN EUROPIANE “PËR
PUNËN E EKIUPAZHEVE TË MJETEVE TË PËRFSHIRA NË TRANSPORTIN
NDËRKOMBËTAR RRUGOR (AETR) DHE NË PROTOKOLLIN E NËNSHKRIMIT E NË
AMENDAMENTIN NR.4 TË SAJ””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen Evropiane “Për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR) dhe në Protokollin e nënshkrimit e në Amendamentin nr.4 të saj””, bërë në Gjenevë më 1 korrik 1970.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 4856, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA EUROPIANE
NË LIDHJE ME PUNËN E EKIUPAZHEVE TË MJETEVE TË PËRFSHIRA NË TRANSPORTIN
NDËRKOMBËTAR RRUGOR (AETR) DHE PROTOKOLLI
I NËNSHKRIMIT

Bërë në Gjenevë, më 1 korrik 1970

Hyrje

Ky është teksti i konsoliduar i Marrëveshjes evropiane në lidhje me punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR), bërë në Gjenevë më 1 korrik 1970. Ky tekst përfshin Marrëveshjen origjinale (E/ECE/811;E/ECE/TRANS/564) të rishikuar nga amendamentet 1-3.

Palët Kontraktuese,

duke dëshiruar të nxisin zhvillimin dhe përmirësimin e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave,

të bindur në domosdoshmërinë e rritjes së sigurisë së qarkullimit rrugor, për të rregulluar disa kushte të punësimit në transportin ndërkombëtar rrugor në përputhje me parimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe së bashku të miratojnë disa masa për të siguruar respektimin e këtij legjislacioni, janë marrë vesh për sa më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

a) “mjet” nënkupton çdo mjet me motor ose rimorkio, ky term përfshin çdo kombinim mjetesht;

b) “mjet me motor” nënkupton çdo mjet të pajisur me një motor tërheqës që qarkullon në rrugë me pajisjet e veta dhe që normalisht shërben për transportin rrugor të udhëtarëve ose të mallrave ose për tërheqjen në rrugë të mjeteve të përdorura për transportin e udhëtarëve ose të mallrave; ky term nuk përfshin traktorët bujqësorë;

c) “rimorkio” nënkupton çdo mjet të destinuar për t’u tërhequr nga një mjet me motor; ky term përfshin gjysmërimorkiot;

d) “gjysmërimorkio” nënkupton çdo rimorkio të destinuar për t’u çiftuar me një mjet me motor në një mënyrë të tillë që ajo të mbështetet pjesërisht mbi mjetin me motor duke mundësuar që një pjesë e rëndësishme e peshës dhe e ngarkesës së saj të përballohen nga mjeti me motor;

e) “tërësi mjeteshe” nënkupton çdo mjet të çiftëzuar që hyn në qarkullimin rrugor si një njësi e vetme;

f) “peshë maksimale, e autorizuar” nënkupton peshën maksimale të mjetit të ngarkuar, e deklaruar si e pranueshme nga autoriteti kompetent i shtetit në të cilin mjeti është regjistruar;

g) “transport rrugor” nënkupton çdo udhëtim të kryer prej një mjeti të caktuar për transportin e udhëtarëve ose të mallrave në rrugë të hapura për përdorimin publik, bosh ose me ngarkesë;

h) “transport ndërkombëtar rrugor” nënkupton çdo transport rrugor që përfshin kalimin e të paktën një kufiri;

i) “shërbime të rregullta të udhëtarëve” nënkupton shërbimet që sigurojnë transportin e udhëtarëve të kryera sipas një frekuence dhe mbi një itinerar të përcaktuar, këto shërbime mund të marrin dhe të lënë udhëtarë në pika qëndrimi të fiksuara paraprakisht:

Një rregullore që rregullon operimin e shërbimeve ose një dokument i ngjashëm me të, i miratuar nga autoritetet publike kompetente të Palëve Kontraktuese dhe të publikuara nga transportuesi përpara fillimit të zbatimit, do të përcaktojë kushtet e transportit, në mënyrë të posaçme frekuencën, oraret, tarifrat dhe detyrimin për të transportuar, për sa kohë që këto kushte nuk janë të parashikuara në një ligj ose urdhëresë.

Shërbimet, pavarësisht se cili është organizatori, që sigurojnë transportin e kategorive të përcaktuara të udhëtarëve duke përjashtuar udhëtarët e tjerë, përsa kohë që këto shërbime kryhen sipas kushteve të përcaktuara në nënparagrafin e parë të këtij përkufizimi, do të konsiderohen gjithashtu si shërbime të rregullta. Këto shërbime, në mënyrë të posaçme shërbimet që sigurojnë transportin e punëtorëve nga dhe për në vendimin e punës apo vendbanimin e tyre ose transportin e nxënësve nga dhe për në shkolla apo vendbanimin e tyre do të quhen më poshtë “shërbime të rregullta të posaçme”.

j) “drejtues mjeti” nënkupton çdo person, me pagesë ose jo, që drejton një mjet transporti edhe gjatë një periudhe të shkurtër ose që është në bordin e mjetit për ta drejtuar atë në çdo kohë që kjo mund të kërkohej;

k) “anëtar ekuipazhi nënkupton një drejtues mjeti ose një nga personat vijues, me pagesë ose jo:

i) një ndihmës drejtues mjeti ose çdo person që shoqëron drejtuesin e mjetit me qëllim që ta asistojë atë në manovra të caktuara dhe që me raste merr pjesë efektivisht në një pjesë të operacioneve të transportit, edhe pse nuk është drejtues mjeti në kuptimin e paragrafit (j) të këtij neni;

ii) një faktorino ose çdo person që shoqëron drejtuesin e një mjeti që transporton udhëtarë dhe që është ngarkuar në mënyrë të posaçme të kontrollojë biletat ose dokumente të tjera që i japin të drejtën udhëtarëve të udhëtojnë me atë mjet;

l) “javë” nënkupton periudhën ndërmjet orës 00.00 të ditës së hënë deri në orën 24.00 të ditës së diele;

m) “pushim” nënkupton çdo periudhë të pandërprerë kohe prej të paktën një ore, kohë të cilën drejtuesi i mjetit vendos lirisht se si ta kalojë.

Neni 2 Qëllimi

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet në territorin e çdo Pale Kontraktuese për çdo transport ndërkombëtar rrugor të kryer nga çdo mjet i regjistruar në territorin e Palës Kontraktuese të sipërpërmendur ose në territorin e çdo Pale tjetër Kontraktuese.

2. Pavarësisht nga sa më sipër: a) nëse gjatë një transporti ndërkombëtar rrugor një ose shumë anëtarë të ekuipazhit nuk dalin nga territori i vendit ku ata ushtrojnë normalisht aktivitetin e tyre profesional, Pala Kontraktuese përgjegjëse për këtë territor mund të mos zbatojë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje kundrejt atij ose atyre anëtarëve të ekuipazhit.

b) për sa kohë që Palët Kontraktuese, në territoret e të cilëve përshkohen, nuk bien dakord ndryshe ndërmjet tyre, kjo Marrëveshje nuk do të zbatohet për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të kryera nga:

1. Mjetet që kryejnë transport mallrash, pesha maksimale e autorizuar e të cilave, përfshirë dhe atë të rimorkiove ose gjysmërimorkiove, nuk i kalon 3.5 tonët;

2. Mjetet që kryejnë transport të udhëtarëve që sipas tipit të konstruksionit dhe të pajisjeve të tyre, janë të afta për të transportuar maksimalisht nëntë persona, duke përfshirë dhe drejtuesin e mjetit dhe që janë të destinuara për këtë qëllim;

3. Mjetet që kryejnë transport të udhëtarëve në shërbime të rregullta në linja, përshkimi i të cilave nuk i kalon 50 kilometrat;

4. Mjetet, shpejtësia maksimale e autorizuar e të cilave nuk i kalon 30 kilometrat në orë;

5. Mjetet e përdorura ose që kontrollohen prej shërbimeve të Forcave të Armatosura, të mbrojtjes civile, të zjarrfikësve dhe të forcave përgjegjëse për rendin publik;

6. Mjetet e përdorura për shërbime në lidhje me mbeturinat dhe ujërat e zeza, për shërbime në lidhje me mbrojtjen ndaj përmytjeve, për shërbime në lidhje me ujin, gazin dhe elektricitetin, për shërbime në lidhje me mirëmbajtjen dhe kontrollin e autostradave, për shërbime në lidhje me heqjen e plehrave, për shërbime komunikimi telegrafik dhe telefonik, për shërbime në lidhje me dërgesat postare, për shërbime në lidhje me transmetimin radiofonik dhe televiziv, si dhe për shërbime në lidhje me zbulimin e lëshuesve ose marrësve të radio-televizionit;

7. Mjetet e përdorura në raste urgjence ose që kryejnë misione shpëtimi;

8. Mjetet e specializuara që kryejnë detyra mjekësore;

9. Mjetet që transportojnë materiale cirku ose panairesh;

10. Mjetet e specializuara për riparime;

11. Mjetet që kryejnë prova në rrugë me qëllim përmirësimin teknik, riparimin ose mirëmbajtjen, si dhe mjetet e reja ose të transformuara të pa vëna ende në qarkullim;

12. Mjetet që përdoren për transportin jo komercial të pasurive private;

13. Mjetet që përdoren për mbledhjen e qumështit në ferma ose që çojnë në ferma bidonët e qumështit ose të prodhimeve të qumështit të destinuara për ushqimin e bagëtisë.

Neni 3

Zbatimi i disa dispozitave të Marrëveshjes për transportin rrugor të kryer nga mjetet e regjistruara në territoret e shteteve jo Palë Kontraktuese

1. Çdo Palë Kontraktuese do të zbatojë në territorin e saj ndaj transportit ndërkombëtar rrugor të kryer nga çdo mjet i regjistruar në territorin e një shteti jo Palë Kontraktuese e kësaj Marrëveshjeje dispozita jo më pak kërkuese se ato që janë parashikuar nga nenet 5,6,7,8,9 dhe 10 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo Palë Kontraktuese, në rastin e një mjeti të regjistruar në një shtet jo Palë Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje mund të kërkojë vetëm fletët e regjistrimit ditor të plotësuara me dorë nga drejtuesi i mjetit në vend të pajisjes së kontrollit në përputhje me specifikimet e aneksit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Parimet e përgjithshme

Çdo Palë Kontraktuese mund të zbatojë minimume më të larta ose maksimume më të ulëta se ato të parashikuara në nenet 5 deri në 8. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje megjithatë mbeten të zbatueshme për drejtuesit e mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar me mjete të regjistruara në një shtet tjetër Palë Kontraktuese ose jo Kontraktuese.

Neni 5

Ekuipezhi

1. Mosha minimale e drejtuesve të mjeteve që kryejnë transport të mallrave do të jetë si më poshtë vijon:

a) 18 vjeç për mjete, duke përfshirë ku është e përshtatshme, rimorkiot ose gjysmërimorkiot, pesha maksimale e autorizuar e të cilave është më e vogël ose e barabartë me 7.5 tonë;

b) për mjetet e tjera: 21 vjeç ose 18 vjeç, me kusht që personi i interesuar të ketë një certifikatë aftësie profesionale, të njohur nga një prej Palëve Kontraktuese që konfirmon përfundimin e një kursi formimi për drejtues mjeti të destinuar për transport rrugor mallrash. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për nivelin minimal të kurseve kombëtare të formimit për drejtues mjeti të kërkuara në vendet e tyre dhe kushtet e tjera të përshtatshme të zbatueshme ndaj drejtuesve të mjeteve të destinuara për transportin e mallrave në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Drejtuesit e mjeteve që kryejnë transporte të udhëtarëve do të jenë të paktën 21 vjeç.

Drejtuesit e mjeteve që kryejnë transporte të udhëtarëve në udhëtime që kalojnë një rreze prej 50 kilometrash prej pikës së qëndrimit të zakonshëm të mjetit do të përmbushin gjithashtu njërin prej kushteve vijuese:

a) të paktën gjatë një viti të kenë ushtruar aktivitetin e drejtuesit të mjetit që kryen transport të mallrave, pesha maksimale e autorizuar e të cilave të jetë më e madhe se 3.5 tonë;

b) të paktën gjatë një viti të kenë ushtruar aktivitetin e drejtuesit të mjetit që kryen transport të udhëtarëve në udhëtime, që kalojnë një rreze prej 50 kilometrash prej pikës së qëndrimit të zakonshëm të mjetit, ose të ndonjë tipi tjetër të transportit të udhëtarëve që nuk i nënshtrohet kësaj Marrëveshjeje për aq kohë sa autoriteti kompetent është bindur se ata kanë fituar në këtë mënyrë përvojën e domosdoshme;

c) të zotërojnë një certifikatë aftësie profesionale që konfirmon kryerjen e një kursi formimi të drejtuesit të mjetit për transport rrugor të udhëtarëve të njohur nga një prej Palëve Kontraktuese.

Neni 6

Periudha e drejtimit të mjetit

1. Kohëzgjatja e drejtimit të mjetit midis dy pushimeve ditore ose midis një pushimi ditor dhe një pushimi javor, që më poshtë do të quhet “periudha e drejtimit ditor” nuk do të kalojë nëntë orë. Ajo mund të zgjatet deri në dhjetë orë jo më shumë se dy herë në javë.

Pas një maksimumi prej gjashtë periudhash të drejtimit ditor, drejtuesi i mjetit do të marrë një pushim javor të tillë, siç përcaktohet në paragrafin 3 të nenit 8.

Periudha e pushimit javor mund të jetë në fund të ditës së gjashtë, nëse kohëzgjatja e përgjithshme e drejtimit të mjetit gjatë gjashtë ditëve nuk e kalon një maksimum që i korrespondon totalit të gjashtë periudhave të drejtimit ditor.

Në rastin e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, i ndryshëm nga ai i shërbimeve të rregullta, fjalët “gjashtë” dhe “i gjashtë” që figurojnë në paragrafët e dytë dhe të tretë, zëvendësohen respektivisht me fjalët “dymbëdhjetë” dhe “i dymbëdhjetë”.

2. Kohëzgjatja e përgjithshme e drejtimit të mjetit nuk duhet të kalojë nëntëdhjetë orë për çdo periudhë dyjavore.

Neni 7

Pushimet

1. Pas katër orë e gjysmë drejtimi të mjetit, drejtuesi do të bëjë një pushim prej të paktën dyzet e pesë minutash, me përjashtim të rastit kur fillon një periudhë pushimi.

2. Ky pushim mund të zëvendësohet nga pushime prej të paktën pesëmbëdhjetë minutash secili, të ndërthurura në periudhën e drejtimit ose menjëherë pas kësaj periudhe në mënyrë që të respektohen dispozitat e paragrafit 1.

3. Gjatë këtyre pushimeve, drejtuesi nuk mund të kryejë punë të tjera. Për qëllime të këtij neni koha e pritjes dhe koha e kaluar pa drejtuar mjetin në një mjet në lëvizje, në një traget ose në një tren nuk do të konsiderohen si punë të tjera.

4. Pushimet e kryera sipas dispozitave më sipër nuk mund të konsiderohen si periudha pushimi ditor.

Neni 8

Periudhat e pushimit

1. Në çdo periudhë prej njëzet e katër orësh, drejtuesi i mjetit përfiton një periudhë pushimi ditor prej të paktën njëmbëdhjetë orësh pa ndërprerje, që jo më shumë se tre herë në javë mund të reduktohet në një minimum prej nëntë orësh pa ndërprerje me kusht që një periudhë pushimi korresponduese t'i jepet për

kompensim përpara fundit të javës vijuese.

Ditët kur pushimi nuk reduktohet në përputhje me paragrafin e parë, pushimi mund të merret në dy ose tre periudha të ndara gjatë 24 orëve, një nga të cilat të jetë të paktën tetë orë pa ndërprerje. Në këtë rast kohëzgjatja minimale e pushimit ditor do të rritet në dymbëdhjetë orë.

2. Gjatë çdo periudhe prej tridhjetë orësh në të cilën kur një mjet ka në bord dhe drejtohet nga të paktën dy drejtues mjeti, secili prej tyre përfiton një pushim ditor prej të paktën tetë orësh pa ndërprerje.

3. Gjatë çdo jave, një nga periudhat e pushimit të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 do të jepet bashkë me pushimin javor me një kohëzgjatje prej 45 orësh pa ndërprerje. Kjo periudhë pushimi mund të reduktohet në një minimum prej 36 orësh pa ndërprerje, nëse ajo merret në vendin e qëndrimit të zakonshëm të mjetit ose në pikën e qëndrimit të zakonshëm të drejtuesit të mjetit ose në një minimum prej 24 orësh pa ndërprerje, nëse ajo merret jashtë këtyre vendeve. Çdo shkurtim kompensohet me një kohë pushimi të barabartë e marrë në bllok përpara fundit të javës së tretë që vijon javën në fjalë.

4. Një periudhë pushimi javor që fillon në një javë dhe që zgjatet në javën vijuese mund t'i bashkohet njëres ose tjetres nga këto javë.

5. Në rastin e transportit të udhëtarëve në të cilët zbatohet paragrafi 1, paragrafi i katërt i nenit 6, atëherë një periudhë pushimi javor mund të shtyhet në javën që vijon dhe mund të bashkohet me pushimin javor të javës së dytë.

6. Të gjitha pushimet e marra si kompensim për reduktimin e periudhave të pushimeve ditore dhe/ose javore do të bashkohen me një pushim tjetër të paktën prej tetë orësh dhe do të jepen, me kërkesën e të interesuarit, në vendin e qëndrimit të zakonshëm të mjetit ose në pikën e qëndrimit të zakonshëm të drejtuesit të mjetit.

7. Pushimet ditore mund të bëhen në mjet, nëse ai është i pajisur me një krevat dhe kryhen kur mjeti është i ndaluar.

8. Pa paragjykuar dispozitat e paragrafit 1 më sipër, në rastin kur, në fushën e transportit të mallrave të udhëtarëve, një drejtues mjeti shoqëron një mjet mbi një traget ose një tren, atëherë pushimi ditor mund të ndërpritet një herë të vetme, me kusht që të plotësohen kushtet vijuese:

- pjesa e pushimit ditor e marrë në tokë duhet të jetë në gjendje të vendoset përpara ose pas pjesës së pushimit ditor të marrë në bordin e tragetit ose trenit;

- periudha midis dy pjesëve të pushimit ditor duhet të jetë sa më e shkurtër të jetë e mundur dhe në asnjë rast nuk mund të kalojë një orë përpara hipjes në traget ose tren ose pas zbritjes, duke përfshirë edhe formalitetet doganore në procedurat e hipjes apo zbritjes në traget ose tren;

- gjatë të dy pjesëve të pushimit ditor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë mundësinë e fjetjes në krevat.

Periudha e pushimit ditor, e ndërprerë në këtë mënyrë, do të zgjatet me dy orë.

Neni 9

Përrjashtimet

Me kusht që të mos komprometohet siguria rrugore dhe me qëllim që atij t'i lejohet të arrijë në një pikë qëndrimi të përshtatshme, drejtuesi i mjetit mund të shmangë zbatimin e dispozitave në këtë Marrëveshje në masën e duhur për të garantuar sigurinë e udhëtarëve, të mjetit ose të ngarkesës së tij. Drejtuesi i mjetit do të shënojë llojin dhe motivin e moszbatimit të dispozitave në këtë Marrëveshje mbi fletën e regjistrimit të pajisjes së kontrollit ose në regjistrin e tij të shërbimit.

Neni 10

Pajisja e kontrollit

1. Palët Kontraktuese do të parashikojnë instalimin dhe përdorimin në mjetet e regjistruara në territorin e tyre të një pajisjeje kontrollit në përputhje me dispozitat vijuese:

a) Pajisja e kontrollit në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje, përsa u përket kushteve të tij të konstruksionit të instalimit, të përdorimit dhe të kontrollit do t'u përgjigjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë këtu edhe aneksin e saj. Pajisja e kontrollit që është në përputhje me dispozitat e këtij neni do të konsiderohet ajo pajisje, që, përsa i përket kushteve të tij të konstruksionit, të instalimit, të përdorimit dhe të kontrollit, është në përputhje me Rregulloren e Këshillit (EEC) nr.3821/85 të datës 20 dhjetor 1985.

b) Nëse nuk është e mundur që një pajisje kontrollit e instaluar në një mjet të përdoret normalisht dhe

në mënyrë të përshtatshme, çdo anëtar ekuipazhi do të regjistrojë me dorë, duke përdorur simbole grafike të përshtatshme, treguesit që lidhen me periudhat e tij të veprimtarisë profesionale dhe të pushimeve në fletën e regjistrimit.

c) Nëse për shkak të largimit nga mjeti, anëtarët e ekuipazhit nuk kanë qenë në gjendje të përdorin pajisjen, ata do të shënojnë me dorë në fletën e regjistrimit, duke përdorur simbole grafike të përshtatshme, periudhat e ndryshme që i korrespondojnë veprimtarisë së tyre profesionale gjatë periudhës kur ata ishin të larguar nga mjeti.

d) Anëtarët e ekuipazhit gjithmonë do të kenë me vete dhe do të paraqesin për kontroll fletët e regjistrimit të javës në vazhdim dhe të ditës së fundit të javës së mëparshme gjatë të cilave ata kanë drejtuar mjetin.

e) Anëtarët e ekuipazhit do të kujdesen që pajisja e kontrollit të jetë në punë dhe të punojë në mënyrë korrekte dhe që në rast defekti ai të riparohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Punëdhënësi do t'u dorëzojë drejtuesve të mjeteve një numër të mjaftueshëm të fletëve të regjistrimit duke pasur parasysh karakterin individual të këtyre fletëve, kohëzgjatjen e shërbimit dhe detyrimin për të zëvendësuar fletët e dëmtuara ose të marra nga një punonjës i kontrollit. Punëdhënësi do t'i japë drejtuesit të mjetit vetëm fletë të një modeli të miratuar të përshtatshëm për t'u përdorur me pajisjen e instaluar në bordin e mjetit.

3. Ndërmarrjet do të ruajnë fletët e regjistrimit të plotësuara në përputhje me dispozitat e paragrafëve b, e dhe d të pikës 1 të këtij neni gjatë një periudhe prej të paktën 12 muajsh pas datës së regjistrimit të fundit dhe t'ua paraqesin ato punonjësve të ngarkuar me kontrollin pas kërkesës së këtyre të fundit.

Neni 11

Mbikëqyrja nga sipërmarrja

1. Sipërmarrja do të organizojë shërbimin e transportit rrugor në një mënyrë të tillë që anëtarët e ekuipazhit të jenë në gjendje të shqyrtojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Ajo do të mbikëqyrë rregullisht periudhat e udhëtimit dhe të punëve të tjera, si dhe orët e pushimit, dhe për këto do të shërbejnë të gjitha dokumentet që ajo disponon, të tilla si librezat individuale të kontrollit. Nëse sipërmarrja konstaton shkelje të kësaj Marrëveshjeje, atëherë ajo do t'u japë fund atyre pa vonesë dhe do të marrë masa për të evituar përsëritjen e tyre, për shembull duke ndryshuar oraret dhe itineraret.

3. Është ndaluar që të shpërblehen drejtuesit e mjeteve të punësuar, qoftë me shpërblime ose me shtesë page në varësi të distancës së përshkuar dhe/ose të vëllimit të mallrave të transportuara, me përjashtim të rasteve kur këto shpërblime janë të një natyre të tillë që nuk komprometojnë sigurinë rrugore.

Neni 12

Masat për zbatimin e Marrëveshjes

1. Çdo Palë Kontraktuese do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar respektimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, në veçanti nëpërmjet kontrolleve të një niveli të përshtatshëm të kryera në rrugë dhe në mjediset e sipërmarrjes. Administratat kompetente të Palëve Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për masat e përgjithshme të marra për këtë qëllim.

2. Palët Kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe për kontrollin e saj.

3. Në kuadrin e kësaj ndihme të ndërsjellë, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do t'i komunikojnë njëra-tjetrës të gjitha informacionet që zotërojnë në lidhje me:

- shkeljet e kësaj Marrëveshjeje të kryera nga personat jorezidentë dhe çdo sanksion të zbatuar për shkelje të tilla;

- sanksionet e zbatuara nga një Palë Kontraktuese për rezidentët e saj për shkelje të tilla të kryera në një Palë tjetër Kontraktuese.

Në rastin e shkeljeve serioze ky informacion do të përfshijë sanksionet e zbatuara.

4. Nëse gjatë një kontrolli në rrugë të drejtuesit të një mjeti të regjistruar në një Palë tjetër Kontraktuese konstatimet e kryera japin arsye të mjaftueshme që të vlerësohet se janë kryer shkelje që nuk janë të zbatueshme gjatë këtij kontrolli në mungesë të elementeve të domosdoshëm, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese në fjalë do t'i japin njëra-tjetrës asistencë me qëllim qartësimin e situatës. Në rastin kur për ta bërë këtë veprim, Pala Kontraktuese kompetente vepron përmes një kontrolli në mjediset e

sipërmarrjes, rezultatet e këtij kontrolli i bëhen të njohura Palës tjetër Kontraktuese në fjalë.

Neni 13

Dispozita të përkohshme

Dispozitat e nenit të ri 10 “Pajisja e kontrollit” nuk do të bëhen të detyrueshme për vendet që janë bërë Palë Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje përpara datës 24 prill 1965. Për këto Pala Kontraktuese, dispozitat e nenit të vjetër 12 “Libreza e kontrollit individual” dhe neni i vjetër 12 bis “Pajisja e kontrollit” do të vazhdojnë të jenë në fuqi.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim deri në datën 31 mars 1971 dhe pas kësaj date për aderim për shtetet anëtare të Komisionit Ekonomik për Evropën dhe shtetet e pranuar në Komision në cilësinë e vëzhguesit, në përputhje me paragrafin 8 të mandatit të këtij Komisioni.

2. Kjo Marrëveshje do të jetë subjekt ratifikimi.

3. Instrumentet e ratifikimit ose të aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

4. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e njëqind e tetëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tetë të ratifikimit ose aderimit.

5. Për çdo shtet, që do të ratifikojë këtë Marrëveshje ose do të aderojë në të pas depozitimit të instrumentit të tetë të ratifikimit ose të aderimit të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e njëqind e tetëdhjetë pas datës së depozitimit nga ky shtet të instrumentit të ratifikimit ose aderimit.

Neni 15

1. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim që i adresohet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi ditën e njëqind e tetëdhjetë pas datës në të cilën Sekretari i Përgjithshëm do të pranojë njoftimin.

Neni 16

Kjo Marrëveshje nuk do të jetë më e vlefshme nëse pas hyrjes së saj në fuqi, gjatë çfarëdo periudhe prej dymbëdhjetë muajsh pa ndërprerje, numri i Palëve Kontraktuese do të jetë më i vogël se tre.

Neni 17

1. Çdo shtet kur do të nënshkruajë këtë Marrëveshje ose do të depozitojë instrumentin e tij të ratifikimit ose të aderimit ose në çdo moment të mëtejshëm, mund të deklarojë nëpërmjet një njoftimi me shkrim të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, se vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje do të shtrihet në të tërë ose në një pjesë të territoreve që ai shtet përfaqëson në planin ndërkombëtar. Kjo Marrëveshje do të zbatohet në territorin ose territoret e përcaktuara në njoftim nga dita e njëqind e tetëdhjetë pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm ose, nëse në këtë datë kjo Marrëveshje nuk ka hyrë akoma në fuqi, nga data e hyrjes së saj në fuqi.

2. Çdo shtet, që në përputhje me paragrafin më sipër, ka bërë një deklaratë, duke e bërë këtë Marrëveshje të zbatueshme në një territor të cilin ai shtet përfaqëson në planin ndërkombëtar, mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në lidhje me territorin e sipërpërmendur në përputhje me nenin 15 më sipër.

Neni 18

1. Çdo Marrëveshje midis dy ose më shumë Palëve Kontraktuese lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për aq sa është e mundur, do të zgjidhet nëpërmjet negociatave midis palëve

në konflikt.

2. Çdo mosmarrëveshje që nuk është zgjidhur nëpërmjet negociatave do t'i nënshtrohet gjykimit të arbitrazhit nëse një nga Palët Kontraktuese në konflikt e kërkon atë dhe për rrjedhojë do t'i dërgohet një ose disa arbitrave të zgjedhur bashkërisht në marrëveshje nga palët në konflikt. Nëse brenda tre muajve nga data e kërkesës për arbitrazh, palët në konflikt nuk arrijnë të merren vesh për zgjedhjen e një arbitri ose disa arbitrave, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të caktojë një arbitër të vetëm tek i cili të dërgohet mosmarrëveshja për gjykim.

3. Vendimi i arbitrit ose i arbitrave të caktuar në përputhje me paragrafin e mëparshëm do të jetë i detyrueshëm për Palët Kontraktuese në konflikt.

Neni 19

1. Çdo shtet, në momentin kur do ta nënshkruajë ose do ta ratifikojë këtë Marrëveshje ose do të aderojë në të, mund të deklarojë që ai nuk do ta konsiderojë veten të lidhur me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje. Palët e tjera Kontraktuese nuk do t'i zbatojnë këto paragrafë ndaj çdo Pale Kontraktuese që do të bëjë një rezervë të tillë.

2. Nëse gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose të aderimit, një shtet formulon një rezervë tjetër nga ato të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'ua komunikojë këtë rezervë shteteve që kanë depozituar tashmë instrumentin e tyre të ratifikimit ose të aderimit dhe nuk e kanë denoncuar më tej këtë Marrëveshje. Rezerva e bërë do të pranohet nëse, në afatin prej gjashtë muajsh duke filluar nga data e këtij komunikimi, asnjë nga këto shtete nuk ka kundërshtuar pranimin e tij. Në rast të kundërt rezerva nuk do të pranohet, depozitimi i instrumentit të ratifikimit ose i aderimit të këtij shteti do të kryhet pa pasoja dhe pse shteti që e ka bërë nuk e ka tërhequr atë. Për zbatimin e këtij paragrafi, kundërshtimi i shteteve, aderimi ose ratifikimi i të cilave është kryer sipas këtij paragrafi duke mos sjellë pasoja përsa i përket rezervave që janë formuluar, nuk do të merret parasysh.

3. Për çdo Palë Kontraktuese, rezerva e së cilës është miratuar në protokollin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje ose që do të formulojë një rezervë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni ose bën një rezervë që është pranuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, në çdo moment mund ta tërheqë këtë rezervë nëpërmjet një njoftimi me shkrim të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 20

1. Pasi kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi gjatë tre vjetëve, çdo Palë Kontraktuese, nëpërmjet njoftimit të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, mund të kërkojë thirrjen e një konference për të revizionuar Marrëveshjen. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua njoftojë këtë kërkesë të gjitha Palëve Kontraktuese dhe do të thërrasë një konferencë revizioni nëse, në një afat prej katër muajsh, që fillon nga njoftimi që atij i është adresuar, të paktën një e treta e Palëve Kontraktuese do t'i njoftojë miratimin e kësaj kërkesë.

2. Nëse një konferencë thirret në përputhje me paragrafët e mëparshëm, Sekretari i Përgjithshëm për atë do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese dhe ato do t'i ftojë që brenda një afati prej tre muajsh të paraqesin propozimet që ato do të dëshironin të shqyrtoheshin nga konferenca. Sekretari i Përgjithshëm do t'u komunikojë të gjitha Palëve Kontraktuese rendin provizor të ditës së konferencës, si dhe tekstin e këtyre propozimeve të paktën tre muaj përpara datës së hapjes së konferencës.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të ftojë në çdo konferencë të thirrur në përputhje me këtë nen të gjitha shtetet e nënvizuara në paragrafin 1 të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose disa amendamente për këtë Marrëveshje. Teksti i çdo projektamendamenti do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili do t'ia komunikojë atë për dijeni të gjitha Palëve Kontraktuese dhe shteteve të tjera të përmendura në paragrafin 1 të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Brenda një afati prej gjashtë muajsh që fillon nga data e komunikimit të projektamendamentit nga Sekretari i Përgjithshëm, çdo Palë Kontraktuese mund t'i bëjë të njohur Sekretarit të Përgjithshëm:

a) se ajo ka vërejtje për amendamentin e propozuar, ose

b) se megjithëse e pranon projektin, kushtet e nevojshme të këtij pranimi nuk plotësohen ende prej këtij shteti.

3. Përderisa një Palë Kontraktuese që ka dërguar njoftimin e parashikuar në paragrafin 2 b të këtij neni nuk do t'i ketë njoftuar Sekretarit të Përgjithshëm pranimin e tij, brenda një afati prej nëntë muajsh që fillon nga mbarimi i afatit prej gjashtë muajsh i parashikuar për njoftimin, ajo mund të paraqesë një vërejtje për amendamentin e propozuar.

4. Nëse një vërejtje formulohet ndaj projektamendamentit në kushtet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, amendamenti do të konsiderohet i papranuar dhe pa asnjë pasojë.

5. Nëse asnjë vërejtje nuk është formuluar ndaj projektamendamentit në kushtet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, amendamenti do të pranohet në datën si më poshtë vijon:

a) nëse asnjë Palë Kontraktuese nuk ka dërguar një njoftim në përputhje me paragrafin 2 b të këtij neni, në mbarim të afatit prej gjashtë muajsh të nënvizuar në paragrafin 2 të këtij neni;

b) nëse të paktën një Palë Kontraktuese ka adresuar një njoftim në përputhje me paragrafin 2 b të këtij neni, në datën më të afërt nga dyja datat vijuese:

- data në të cilën të gjitha Palët Kontraktuese që kanë adresuar një njoftim të tillë do të njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e projektit prej tyre, datë që do të konsiderohet edhe si mbarimi i afatit prej gjashtë muajsh të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni nëse të gjitha pranimet janë njoftuar para mbarimit të këtij afati; ose

- data në të cilën mbaron afati prej nëntë muajsh të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.

6. Çdo amendament i pranuar do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën ai do të jetë pranuar.

7. Sekretari i Përgjithshëm, sa më shpejt që të jetë e mundur, do t'i adresojë të gjitha Palëve Kontraktuese një njoftim për t'u bërë të ditur atyre nëse është formuluar një vërejtje kundër projektamendamentit në përputhje me paragrafin 2a të këtij neni dhe nëse një ose shumë Palë Kontraktuese i kanë adresuar atij një njoftim në përputhje me paragrafin 2b të këtij neni. Në rastin kur një ose disa Palë Kontraktuese i kanë adresuar një njoftim të tillë, ai do t'i njoftohet të gjitha Palëve Kontraktuese nëse Pala ose Palët Kontraktuese që kanë bërë një njoftim të tillë bëjnë një vërejtje kundër projektamendamentit ose e pranojnë atë.

8. Pavarësisht nga procedura e amendamentit e parashikuar në paragrafët 1 deri në 6 të këtij neni, aneksi i kësaj Marrëveshjeje mund të modifikohet në Marrëveshje midis administratave kompetente të të gjitha Palëve Kontraktuese; nëse administrata kompetente e një Pale Kontraktuese ka deklaruar që e drejta e saj kombëtare e detyron atë që të miratojë Marrëveshjen me marrjen e një autorizimi special për këtë qëllim ose me miratimin nga një organ legjislativ, atëherë pranimi i administratës kompetente të Palës Kontraktuese në fjalë për ndryshimin e aneksit do të konsiderohet si i dhënë vetëm në momentin kur kjo administratë kompetente do t'i deklarojë Sekretarit të Përgjithshëm që autorizimet ose miratimet e kërkuara janë marrë. Marrëveshja midis administratave kompetente do të fiksojë datën e hyrjes në fuqi të aneksit të ndryshuar dhe mund të parashikojë që gjatë një periudhe transitorie aneksi i vjetër i ndryshuar do të mbetet në fuqi në tërësi ose në një pjesë të caktuar njëkohësisht me aneksin e ndryshuar.

Neni 22

1. Shtojcat 1 dhe 2 të aneksit të kësaj Marrëveshjeje mund të amendohen sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

2. Me kërkesë të një Pale Kontraktuese, çdo amendament i shtojcave 1 dhe 2 të aneksit të kësaj Marrëveshjeje, propozuar nga kjo Palë Kontraktuese do të shqyrtohet nga grupi kryesor i punës i transportit rrugor të Komisionit Ekonomik për Evropën.

3. Nëse miratohet me votën e shumicës së anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote, dhe nëse kjo shumicë përbën shumicën e Palëve Kontraktuese të pranishme me të drejtë vote, amendamenti do t'i komunikohet për pranim administratave kompetente të të gjitha Palëve Kontraktuese nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. Amendamenti do të pranohet nëse, brenda një afati prej gjashtë muajsh që pason datën e këtij njoftimi, më pak se një e treta e administratave kompetente të Palëve Kontraktuese i njoftojnë Sekretarit të Përgjithshëm vërejtje ndaj amendamentit.

5. Çdo amendament i pranuar do t'i komunikohet të gjitha Palëve Kontraktuese nga Sekretari i Përgjithshëm dhe do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së këtij njoftimi.

Neni 23

Përveç njoftimeve të parashikuara në nenet 20 dhe 21 të kësaj Marrëveshjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'i njoftojë shteteve të përmendura në paragrafin 1 të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje:

- a) çdo ratifikim dhe aderim në përputhje me nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje;
- b) çdo datë në të cilën kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje;
- c) çdo denoncim në përputhje me nenin 15 të kësaj Marrëveshjeje;
- d) çdo abrogim të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje;
- e) çdo njoftim të marrë në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje;
- f) çdo deklaratë dhe njoftim të marrë në përputhje me nenin 19 të kësaj Marrëveshjeje;
- g) çdo hyrje në fuqi të një amendamenti në përputhje me nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 24

Protokolli i nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje do të ketë të njëjtën fuqi, vlerë dhe kohëzgjatje me vetë Marrëveshjen, pjesë integrale e së cilës ajo është.

Neni 25

Pas datës 31 mars 1971, origjinali i kësaj Marrëveshjeje do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që do t'i dërgojë një kopje të vërtetuar çdo shteti të nënvizuar në paragrafin 1 të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

ANEKS PAJISJA E KONTROLLIT

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME I. MIRATIMI TIP

Neni 1

Aplikimet për miratimin e një lloji të pajisjes së kontrollit ose të një modeli të fletës së regjistrimit, të shoqëruara me specifikimet e përshtatshme do t'i dorëzohen një Palë Kontraktuese nga prodhuesi ose agjenti i tij. Asnjë aplikim në lidhje me ndonjë lloj të pajisjes së kontrollit ose të një modeli të fletës së regjistrimit nuk mund t'i dorëzohet më shumë se një Palë Kontraktuese.

Neni 2

Një Palë Kontraktuese do të japë miratimin e saj për çdo lloj të pajisjes së kontrollit ose çdo model të fletës së regjistrimit që plotëson kërkesat e vendosura në shtojcën 1 të këtij aneksi, me kusht që Pala Kontraktuese të jetë në gjendje të kontrollojë përputhshmërinë e modeleve të prodhimit me prototipat e miratuara.

Çdo modifikim ose shtesë ndaj një modeli të miratuar duhet të marrë miratimin tip shtesë nga Pala Kontraktuese e cila ka dhënë miratimin e parë tip.

Neni 3

Palët Kontraktuese do të pajisin aplikantin me një markë miratimi, e cila duhet të jetë në përputhje me modelin e treguar në shtojcën 2 për çdo lloj të pajisjes së kontrollit ose modeli të fletës së regjistrimit që ato miratojnë sipas nenit 2.

Neni 4

Autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese të cilës i është dorëzuar aplikimi për miratimin tip, në lidhje me çdo lloj të pajisjes së kontrollit ose modelit të fletës së regjistrimit që ato miratojnë ose refuzojnë të miratojnë, duhet t'i dërgojnë autoriteteve të Palës tjetër Kontraktuese një kopje të certifikatës së miratimit, të shoqëruar me kopje të specifikimeve përkatëse jo më vonë se pas një periudhe njëmuajore ose, nëse është kështu, t'i njoftojnë ato autoritete se miratimi është refuzuar. Në rast refuzimi ato do të komunikojnë arsyet e vendimit të tyre.

Neni 5

1. Nëse një Palë Kontraktuese, e cila ka lëshuar miratimin tip siç parashikohet në nenin 2, zbulon se disa pajisje të kontrollit ose fletë regjistrimi që mbajnë markën e miratimit tip të cilën e ka lëshuar, nuk përputhen me prototipin që ka lëshuar, do të marrë masat e nevojshme për t'u siguruar që modelet e prodhimit të përputhen me prototipat e miratimit. Masat e marra, nëse është e nevojshme, mund të shtrihen deri në tërheqjen e miratimit tip.

2. Një Palë Kontraktuese e cila ka lëshuar miratimin tip do të tërheqë një miratim të tillë nëse pajisja e kontrollit ose fleta e regjistrimit që është miratuar nuk është në përputhje me këtë aneks ose shtojcat e tij, ose shfaq në përdorim ndonjë defekt të përgjithshëm, i cili nuk e përmbush qëllimin e saj.

3. Nëse një Palë Kontraktuese që ka lëshuar miratimin tip njoftohet nga një Palë tjetër Kontraktuese për një nga rastet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2, pasi të konsultohet me Palën e dytë Kontraktuese, do të marrë hapat e vendosur në këto paragrafë sipas paragrafit 5.

4. Një Palë Kontraktuese që verifikon se ka ndodhur një nga rastet e përmendura në paragrafin 2, mund të ndalojë deri në një njoftim të dytë nxjerrjen në treg ose vënien në përdorim të pajisjes së kontrollit ose fletëve të regjistrimit, kjo zbatohet edhe për rastet e përmendura në paragrafin 1, në lidhje me pajisjen e kontrollit ose fletët e regjistrimit, të cilat janë përjashtuar nga verifikimi fillestar, nëse prodhuesi, pas paralajmërimit përkatës, nuk e përshtat pajisjen me modelin e miratuar ose me kërkesat e këtij aneksi. Në çdo rast, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën brenda një muaji, për çdo tërheqje të miratimit tip ose të ndonjë mase tjetër të marrë në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 dhe do të parashtrijë arsyet e një veprimi të tillë.

5. Nëse një Palë Kontraktuese e cila ka lëshuar miratimin tip mohon ekzistencën e ndonjë rasti të parashtruar në paragrafët 1 ose 2 që i është bërë i ditur, Palët Kontraktuese të interesuara do të përpiqen ta zgjidhin këtë kontradiktë.

Neni 6

1. Një aplikues për miratimin tip të një modeli fletë regjistrimi do të deklarojë në aplikimin e tij llojin ose llojet e pajisjes së kontrollit në të cilën fleta në fjalë përcaktohet të përdoret dhe do të sigurojë pajisjen e përshtatshme të një lloji ose llojeve në funksion të qëllimit të testimit të fletës.

2. Autoritetet kompetente të secilës Palë Kontraktuese do të shënojnë në certifikatën e miratimit të modelit të fletës së regjistrimit llojin ose llojet e pajisjes së kontrollit për të cilën mund të përdoret ai model flete.

Neni 7

Palët Kontraktuese ndalohen të refuzojnë regjistrimin e ndonjë mjeti të pajisur me në pajisje kontrolli, ose të ndalojnë hyrjen në shërbim apo përdorimin e një mjeti të tillë për ndonjë arsye lidhur me faktin se mjeti është i pajisur me një pajisje të tillë, nëse pajisja mban markën e miratimit të përmendur në nenin 3 dhe pllakën e instalimit të përmendur në nenin 9.

Neni 8

Të gjitha vendimet në përputhje me këtë aneks, që refuzojnë ose tërheqin miratimin e një lloji të pajisjes së kontrollit ose modeli të fletës së regjistrimit do të specifikojë me detaje arsyet mbi të cilat bazohen. Një vendim do t'i komunikohet palës së interesuar, e cila në të njëjtën kohë do të informohet për zhdëmtimet e mundshme për të, sipas ligjeve të Palës Kontraktuese dhe të kufizimeve të afateve kohore për ushtrimin e këtyre zhdëmtimeve.

II. INSTALIMI DHE INSPEKTIMI

Neni 9

1. Pajisja e kontrollit mund të instalohet ose riparohet nga mekanikë ose ofiçina të miratuara nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese për atë qëllim, pasi këto të fundit, nëse dëshirojnë, të kenë dëgjuar mendimet e prodhuesve të interesuar.

2. Mekanika ose ofiçina e miratuar do të vendosë në markë specifike mbi vulat që vendos. Autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese do të mbajnë një regjistër të markave të përdorura.

3. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do t'i dërgojnë njëra-tjetrës listat e tyre të mekanikëve ose ofiçinave të miratuara, si dhe kopje të markave të përdorura.

4. Për të vërtetuar se instalimi i pajisjes së kontrollit është kryer në përputhje me kërkesat e këtij aneksi, do të përdoret një pllakë instalimi, e vendosur siç parashikohet në shtojcën 1.

III. PËRDORIMI I PAJISJES

Neni 10

Punëdhënësi dhe drejtuesi i mjetit do të jenë përgjegjës për monitorimin e funksionimit të pajisjes.

Neni 11

1. Drejtuesit e mjetit nuk do të përdorin fletë regjistrimi të papastrat ose të dëmtuara. Fletët do të jenë të mbrojtura.

Në rast dëmtimi të një flete që mban të dhënat, drejtuesit e mjetit do të bashkëlidhin fletën e dëmtuar me një fletë rezervë të përdorur për ta zëvendësuar atë.

2. Drejtuesit e mjetit do të përdorin fletën e regjistrimit çdo ditë në të cilën ata ngasin mjetin, duke filluar nga momenti që e marrin në ngarkim. Fleta e regjistrimit nuk do të tërhiqet përpara përfundimit të periudhës ditore të punës, vetëm me përjashtim të rastit kur autorizohet tërheqja e saj. Ndalohej përdorimi i fletës së regjistrimit për të mbuluar një periudhë më të gjatë se ajo për të cilën është synuar. Kur si rezultat i të qenurit larg mjetit, një drejtues nuk është në gjendje të përdorë pajisjen e përshtatur për mjetin, periudhat e kohës do të regjistrohen në fletë ose me dorë, ose në mënyrë automatike apo me mjete të tjera, në mënyrë të lexueshme dhe pa e ndotur fletën.

Nëse ka më shumë se një drejtues në bord të mjetit, drejtuesit e mjetit do të amendojnë fletët e regjistrimit sipas nevojës, në mënyrë që informacioni i përmendur në kapitullin 1 deri 3 të shtojcës 1 të jetë regjistruar në fletën e regjistrimit të drejtuesit të mjetit që është duke ngarë aktualisht.

3. Pajisja e kontrollit do të projektohet në mënyrë që një oficer inspektimi i autorizuar, nëse është e nevojshme pas hapjes së pajisjes, të mund të lexojë të dhënat në lidhje me nëntë orët që i paraprijnë kohës së kontrollit pa deformuar, dëmtuar ose njollosur fletën në mënyrë të riparueshme.

Më tej, pajisja e kontrollit do të projektohet në mënyrë që, edhe pa e hapur kutinë, të verifikohet se janë mbajtur të dhënat.

4. Kur kërkohet nga një oficer inspektimi i autorizuar për të bërë këtë gjë, drejtuesi i mjetit duhet të jetë në gjendje të paraqesë fletët e regjistrimit për javën aktuale dhe në ndonjë rast për ditën e fundit të javës së kaluar në të cilën ai ka drejtuar mjetin.

ANEKSI SHTOJCA 1

KËRKESA PËR NDËRTIMIN, TESTIMIN, INSTALIMIN DHE INSPEKTIMIN

I. PËRKUFIZIME

Në këtë shtojcë, termi:

a) "pajisje kontrolli" nënkupton pajisjen e synuar për t'u instaluar në mjetet rrugore për të treguar dhe regjistruar automatikisht ose gjysmë automatikisht detajet e lëvizjes së këtyre mjeteve dhe të disa periudhave të punës së drejtuesve të tyre.

b) “fletë regjistrimi” nënkupton një fletë të përcaktuar për të pranuar dhe ruajtur të dhëna të regjistruara, për t’u vendosur në pajisjen e kontrollit dhe në të cilën mekanizmi i shënimit të këtij të fundit përshkruan një regjistrim të vazhdueshëm të informacionit që duhet regjistruar.

c) “konstante e pajisjes së kontrollit” nënkupton karakteristikën numerike që jep vlerën e sinjalit të hyrjes së nevojshme për të marrë treguesin dhe regjistrimin e një distance të përshkruar prej 1 km; kjo konstante duhet të shprehet qoftë në rrotullime për kilometër ($k = \dots \text{rrot/km}$), qoftë në impulset për kilometër ($k = \dots \text{imp/km}$).

d) “koeficient karakteristik i mjetit” nënkupton karakteristikën numerike që jep vlerën e sinjalit të daljes, të lëshuar nga pjesa e parashikuar në mjet për rakordimin e saj me pajisjen e kontrollit (të marrë në dalje të kutisë së shpejtësisë në disa raste dhe në rrota të mjetit në raste të tjera), kur mjeti përshkruan distancën prej 1 km të matur në kushtet normale të provës (shih kapitullin VI paragrafi 4 i kësaj shtojce). Koeficienti karakteristik shprehet qoftë në rrotullime për kilometër ($\dot{e} = \dots \text{rrot/km}$), qoftë në impulse për kilometër ($\ddot{e} = \dots \text{imp/km}$);

e) “rreth efektiv i gomave në rrugë” nënkupton distancat mesatare të përshkimit të çdo rrote që vënë në lëvizje mjetin (rrotat aktive) gjatë një rrotullimi të plotë. Masa e këtyre distancave duhet të bëhet në kushte normale të provës (shih kapitullin VI paragrafi 4 i kësaj shtojce) dhe shprehet në formën “ $1 = \dots \text{mm}$ ”.

II. KARAKTERISTIKAT DHE FUNKSIONET E PËRGJITHSHME TË PAJISJES SË KONTROLLIT

Pajisja e kontrollit duhet të bëjë regjistrimin e elementeve të mëposhtme:

1. distancën e përshkruar nga mjeti;
2. shpejtësinë e mjetit;
3. kohët e udhëtimit;
4. kohët e tjera të punës ose të gatishmërisë;
5. ndërprerjet e punës dhe periudhat e pushimit ditor;
6. hapjen e kutisë që përmban fletën e regjistrimit;
7. për pajisjen elektronike të kontrollit që funksionon mbi bazën e sinjaleve të transmetuara në mënyrë elektronike nga sensori i distancës dhe i shpejtësisë, mat çdo ndërprerje të furnizimit me më shumë se 100 milisekonda të pajisjes së regjistrimit (përfshijë ndriçimin), të furnizimit të sensorit të distancës dhe të shpejtësisë dhe çdo ndërprerje të sinjalit të sensorit të distancës dhe të shpejtësisë.

Për mjetet që përdoren nga dy drejtues mjetesh, pajisja e kontrollit duhet të lejojë regjistrimin e kohëve të theksuara në pikën 3, 4 dhe 5 në mënyrë të njëkohshme dhe të diferencuar në dy fletë të veçanta.

III. KUSHTET E NDËRTIMIT TË PAJISJES SË KONTROLLIT

A. TË PËRGJITHSHME

1. Pajisja e kontrollit do të përfshijë sa më poshtë vijon:

a) pajisje treguese:

- të distancës së përshkruar (llogaritja shumatore);
- të shpejtësisë (shpejtësimatës);
- të kohëve (orë);

b) pajisje regjistruese që përmbajnë:

- një regjistruer të distancës së përshkruar;
- një regjistruer të shpejtësisë;
- një ose disa regjistruer kohorë që përmbushin kushtet e vendosura në kapitullin III, C4;

c) një pajisje shënuese që tregon në mënyrë të ndarë në fletën e regjistrimit:

- çdo hapje të kutisë që përmban këtë fletë;
- për pajisjet elektronike të kontrollit, siç përcaktohet në pikën 7 të kapitullit II, çdo ndërprerje të furnizimit më të madhe se 100 milisekonda të pajisjes së kontrollit (me përjashtim të ndriçimit), jo më vonë se momenti i rifurnizimit;

- për pajisjet elektronike të kontrollit siç përcaktohen në pikën 7 të kapitullit II, çdo ndërprerje e furnizimit më të madhe se 100 milisekonda të sensorit të distancës dhe të shpejtësisë dhe çdo ndërprerje të sinjalit të sensorit të distancës dhe të shpejtësisë.

2. Përfshirja në pajisje e mjeteve të tjera nga ato të listuara më lart nuk duhet të komprometojë mirëfunksionimin e pajisjeve detyruese dhe as të pengojë leximin e tyre.

Pajisja e kontrollit duhet të dorëzohet për miratim të plotë, së bashku me çdo pajisje të tillë shtesë.

3. Materiale

a) Çdo element përbërës i pajisjes së kontrollit duhet të realizohet me materiale të një stabiliteti dhe rezistence mekanike të mjaftueshme dhe nga karakteristika elektrike dhe manjetike të qëndrueshme.

b) Çdo modifikim në një pjesë përbërëse të pajisjes së kontrollit ose në natyrën e materialeve të përdorura për prodhimin e saj duhet të miratohet, përpara se të hidhet në prodhim, nga autoriteti që ka lëshuar miratimin tip për pajisjen e kontrollit.

4. Matja e distancës së përshkuar

Distancat e përshkuara mund të maten dhe të regjistrohen ose:

- duke përfshirë lëvizjen para dhe mbrapa, ose

- duke përfshirë vetëm lëvizjen para.

Çdo regjistrim i lëvizjeve prapa nuk duhet të ndikojë absolutisht në qartësinë dhe saktësinë e regjistrimeve të tjera.

5. Matja e shpejtësisë

a) Niveli i matjes së shpejtësisë do të jetë në përputhje me atë që përmendet në certifikatën e miratimit tip.

b) Frekuenca dhe pajisja amortizuese e mekanizmit të matjes duhet të jenë të tilla që pajisjet treguese dhe regjistruese të shpejtësisë të mund të ndjekin ndryshimet e shpejtësisë deri në 2 m/s^2 , në kufijtë e tolerancave të pranuar.

6. Matja e kohës (ora)

a) Kontrolli i mekanizmit të regjistrimit të orës duhet të gjendet në brendësi të një kutie që përmban fletën e regjistrimit, çdo hapje e së cilës duhet të shënohet automatikisht në fletën e regjistrimit.

b) Nëse mekanizmi i lëvizjes para i fletës së regjistrimit kontrollohet nga ora, periudha gjatë të cilës kjo e fundit do të mirëfunxionojë pasi të jetë kurdisur plotësisht, duhet të jetë të paktën 10 për qind më e madhe se periudha e regjistrimit që i korrespondon ngarkesës maksimale të fletës së pajisjes.

7. Ndriçimi dhe mbrojtja

a) Mjetet vizuale të pajisjes së kontrollit duhen të pajisen me një ndriçim të mjaftueshëm joverbues.

b) Për kushte normale të përdorimit, të gjitha pjesët e brendshme të pajisjes së kontrollit duhet të mbrohen kundrejt lagështirës dhe pluhurit. Përveç kësaj ato duhet të ruhen kundrejt prishjes së mbështjelljeve të vulosura.

B. MJETET VIZUALE

1. Treguesi i distancës së përshkuar (regjistruesi i distancës)

a) Vlera më e vogël e ndarjeve të pajisjes së kontrollit që shpreh distancën e përshkuar duhet të jetë 0.1 km. Shifrat që shprehin hektometrat duhet të jenë të ndara nga ato që shprehin kilometra të plotë.

b) shifrat e regjistruerit të distancës duhet të jenë qartësisht të lexueshme dhe të kenë një lartësi të dukshme të paktën 4 mm.

c) Regjistruesi i distancës duhet të lexojë deri të paktën 99 999,9 km.

2. Treguesi i shpejtësisë (matësi i shpejtësisë)

a) Brenda kufijve të matjes, shkalla e shpejtësisë duhet të gradohet në mënyrë uniforme me 1, 2, 5 ose 10 km/orë. Vlera e një ndarjeje të shpejtësisë (intervali kohor midis dy ndarjeve të njëpasnjëshme) nuk duhet të kalojë 10 për qind të shpejtësisë maksimale që tregon shkallëzimi.

b) kufiri i treguar përtej atij të matur nuk nevojitet të tregohet me shifra.

c) gjatësia e çdo hapësire në shkallë që i korrespondon një diferencë të shpejtësisë prej 10 km/orë nuk duhet të jetë më e vogël se 10 mm.

d) Në një tregues me shigjetë, distanca midis shigjetës dhe fushës së pajisjes së kontrollit nuk duhet të kalojë 3 mm.

3. Treguesi i kohës (ora)

Treguesi i kohës duhet të jetë i dukshëm nga jashtë pajisjes së kontrollit dhe leximi duhet të jetë i sigurt, i lehtë dhe jo i dykuptimtë.

C. PAJISJET REGJISTRUESE

1. Të përgjithshme

a) Në çdo pajisje, cilado qoftë forma e fletës së regjistrimit (shirit ose disk), duhet të parashikohet një markë që lejon një vendosje korrekte të fletës së regjistrimit, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria ndërmjet kohës së treguar nga ora dhe kohës së shënuar në fletë.

b) Mekanizmi që vë në lëvizje fletën e regjistrimit duhet të garantojë që ajo të lëvizë pa pengesë dhe të vendoset e të hiqet lirshëm.

c) Për fletët e regjistrimit në formë disku, pajisja e lëvizjes para duhet të kontrollohet nga mekanizmi i orës. Në këtë rast, lëvizja me rotacion e fletës do të jetë e vazhdueshme dhe uniforme, me një shpejtësi minimale prej 7 mm/orë në bordin e brendshëm të kurorës qarkulluese që përcaktojnë zonën e regjistrimit të shpejtësisë.

Në pajisjet e tipit me shirit, kur pajisja e lëvizjes para të fletëve kontrollohet nga një mekanizëm ore, shpejtësia e lëvizjes drejtvizore para do të jetë të paktën 10 mm/orë.

d) Regjistrimet e distancës së përshkuar të shpejtësisë së mjetit dhe të hapjes së kutisë që përmban fletën ose fletët e regjistrimit duhet të jenë automatike.

2. Regjistrimi i distancës së përshkuar

a) Çdo distancë e përshkuar prej 1 km duhet të paraqitet me diagram nëpërmjet një zhvendosjeje prej të paktën 1 mm të koordinatës korresponduese.

b) Po ashtu, për shpejtësitë që ndodhen në kufijtë superiorë të kufijve të matjes, diagrame e përshkimeve duhet të jetë e qartë dhe e lexueshme.

3. Regjistrimi i shpejtësisë

a) cilado qoftë forma e fletës së regjistrimit, gjilpëra e regjistrimit të shpejtësisë duhet të ketë një parim një lëvizje drejtvizore dhe perpendikulare me drejtimin e zhvendosjes së fletës së regjistrimit.

Megjithatë, një lëvizje në trajtë kurbe e gjilpërës mund të pranohet nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjurma nga gjilpëra është perpendikulare me rrethin mesatar (në rastin e fletëve në formë disku) ose me aksin e zonës së rezervuar për regjistrimin e shpejtësisë (në rastin e fletës në formë shiriti);

- raporti midis rajonit të kurbuar të gjurmës së përshkuar nga gjilpëra dhe gjerësisë së zonës së rezervuar të regjistrimit të shpejtësisë nuk duhet të jetë më i ulët se 2,4:1, cilado qoftë forma e fletës së regjistrimit;

- gjurmët e ndryshme të shkallës kohore duhet të përshkojnë zonën e regjistrimit sipas një kurbe të të njëjtit rajon si gjurma e përshkuar nga gjilpëra. Distanca midis vijave në shkallën kohore duhet të përfaqësojë një periudhë jo më të gjatë se një orë.

b) Çdo variacion në shpejtësi prej 10 km/orë duhet të paraqitet në diagram nga një variacion prej të paktën 1.5 mm i koordinatës korresponduese.

4. Regjistrimi i kohës

a) Pajisja e kontrollit duhet të ndërtohet në atë mënyrë që gjithmonë të regjistrojë kohën e drejtimit në mënyrë krejt automatike dhe që të jetë në gjendje, përmes operimit ku të jetë e nevojshme të një pajisjeje ndërruese, të regjistrojë në mënyrë të ndarë periudhat e tjera kohore si vijon:

i) me shenjën: kohën e drejtimit;

ii) me shenjën: të gjitha periudhat e tjera të punës;

iii) me shenjën: periudhat e tjera të disponueshmërisë, kryesisht;

- kohën e pritjes, që nënkupton periudhën gjatë së cilës drejtuesit nuk janë të detyruar të qëndrojnë në vendin e tyre të punës, përveçse kur duhet t'i përgjigjen thirrjeve të mundshme, me qëllim që të ndërmarrin ose rimarrin drejtimin e mjetit apo të bëjnë punë të tjera;

- kohën e kaluar përkrah një drejtuesi të mjetit, kur mjeti është në lëvizje;

- kohën e kaluar në një shtrat rrethor, kur mjeti është në lëvizje;

iv) me shenjën: ndërprerjet e punës dhe periudhat e pushimit ditor.

Çdo Palë Kontraktuese mund të lejojë që të gjitha periudhat e kohëve të lartpërmendura në pikën ii) dhe iii), të regjistrohen nën shenjën e vendosur në fletët e regjistrimit të përdorura në mjetet e regjistruara në territorin e saj.

b) Duhet të jetë e mundur, nga karakteristikat e gjurmëve, pozicionet e tyre relative dhe nëse është e nevojshme shenjave të parashtruara në paragrafin 4 a) të dallosh qartësisht ndërmjet periudhave të ndryshme kohore.

Periudhat e ndryshme kohore duhet të diferencohen nga njëra-tjetra në diagram nga ndryshimet në dendësinë e gjurmëve përkatëse ose nga çdo sistem tjetër, të paktën i barabartë nga pikëpamja e lejueshmërisë dhe e interpretimit të lehtë të diagramës.

c) Në rastin e mjetit të përdorur nga një ekip i përbërë prej më shumë se një drejtues, regjistrimet e parashikuara në paragrafin 4 a) duhet të realizohen në dy fletë të veçanta, secila e dhënë për një drejtues. Në këtë rast, lëvizja para e fletëve të veçanta duhet të sigurohet nga një mekanizëm i vetëm ose nga një mekanizëm i sinkronizuar.

D. PAJISJA E MBYLLJES

1. Kutia që përmban fletën ose fletët e regjistrimit dhe kontrollin e mekanizmit për vendosjen e orës duhet të jetë e pajisur me një bravë.

2. Çdo hapje e kutisë që përmban fletën ose fletët e regjistrimit dhe kontrollin e mekanizmit për vendosjen e orës duhet të shënohet automatikisht mbi fletën ose fletët.

E. MBISHKRIMET

1. **Fusha e pajisjes së kontrollit duhet të ketë mbishkrimet e mëposhtme:**

- pranë shifrës së treguar nga treguesi i distancës, njësia e matjes së distancës, treguar me shkurtimin “km”,

- pranë shkallës së shpejtësisë, mbishkrimi “km/orë”,

- në hapësirën përkatëse të matësit të shpejtësisë të shënohet “Vmin...km/orë, Vmax...km/orë”. Ky mbishkrim nuk është i nevojshëm nëse ai figuron në pllakën përshkuese të pajisjes.

Megjithatë, këto kërkesa nuk zbatohen për pajisjet e kontrollit të miratuara përpara datës 10 gusht 1970.

2. **Pllaka përshkuese duhet të jetë e vendosur në pajisje dhe të tregojë mbishkrimet e mëposhtme, të cilat duhet të jenë të dukshme në pajisjen e kontrollit, kur instalohen:**

- emrin dhe adresën e fabrikuesit të pajisjes;

- numrin e fabrikuesit dhe vitin e ndërtimit;

- markën e miratimit për llojin e pajisjes së kontrollit;

- konstanten e pajisjes në formën “K=...rot/km” ose “K=...imp/km”;

- sipas dëshirës, kufijtë e matjes së shpejtësisë, në formën e treguar në paragrafin 1;

- nëse ndjeshmëria e instrumentit të këndit të animit është e aftë të influencojë në treguesit e dhënë nga pajisja më tepër se tolerancat e pranuar, këndi i pranueshëm shprehet në formën:

+ b

- g

në të cilën...është këndi i matur, duke filluar nga pozicioni horizontal i faqes përpara (i orientuar lart) i pajisjes për të cilin kalibrohet instrumenti, ndërsa...dhe...paraqesin përkatësisht shmangiet e lejueshme maksimale lart dhe poshtë nga këndi i kalibrit.

F. TOLERANCAT MAKSIMALE (PAJISJET TREGUESE DHE REGJISTRUESE)

1. Bankëprova përpara instalimit:

a) distanca e përshkuar:

plus minus 1 për qind të distancës reale, ku distanca është të paktën një 1 km;

b) shpejtësia:

plus minus 3 km/orë në raport me shpejtësinë reale;

c) koha:

plus minus 2 min në ditë me një maksimum prej 10 min në 7 ditë në rastin kur kohëzgjatja e punës së orës pas remontimit të mos jetë më e vogël se kjo periudhë.

2. Instalimi:

a) distanca e përshkuar:

plus minus 2 për qind e distancës reale kur kjo distancë është jo më pak se 1 km;

b) shpejtësia:

plus minus 4 km/orë në raport me shpejtësinë reale;

c) koha:

plus minus 2 min në ditë, ose

plus minus 10 min në 7 ditë.

3. Në përdorim:

a) distanca e përshkuar:

plus minus 4 për qind e distancës reale, kur kjo distancë është jo më pak se 1 km;

b) shpejtësia:

plus minus 6 km/orë në raport me shpejtësinë reale;

c) koha:

plus minus 2 min në ditë, ose

plus minus 10 min në 7 ditë.

4. Tolerancat maksimale të përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 janë të vlefshme për temperatura ndërmjet 0 dhe 40⁰ C, temperatura që maten shumë afër pajisjes.

5. Matjet e tolerancave maksimale të përmendura në paragrafët 2 dhe 3 do të bëhen sipas kushteve të

vendosura në kapitullin VI.

IV. FLETA E REGJISTRIMIT

A. TË PËRGJITHSHME

1. Fletët e regjistrimit duhet të jenë të një cilësie të tillë që ato të mos pengojnë funksionimin normal të pajisjes dhe që regjistrimet që ato përmbajnë të jenë të pashlyeshme dhe qartësisht të lexueshme dhe të identifikueshme.

Fletët e regjistrimit duhet të ruajnë dimensionet e tyre dhe çdo regjistrim të bërë në to në kushte normale të lagështirës dhe temperaturës.

Përveç kësaj, për çdo anëtar të ekuipazhit, duhet të jetë e mundur që të regjistrojë në fletët, pa i prishur dhe pa penguar lejueshmërinë e regjistrimeve, informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe mbiemrin e tij në fillim të përdorimit të fletës;

b) datën dhe vendin e fillimit të përdorimit të fletës, si dhe datën dhe vendin kur përfundon përdorimi;

c) numrin e regjistrimit të secilit mjet që i është caktuar, si në fillim të udhëtimit të parë të regjistruar mbi fletë dhe pastaj, në rast ndryshimi të mjetit, gjatë përdorimit të fletës;

d) leximin e kilometrazhit;

- në fillim të udhëtimit të parë të regjistruar në fletë;

- në fund të udhëtimit të fundit të regjistruar në fletë;

- në rast ndërrimi të mjetit gjatë ditës së punës (leximin e mjetit tek i cili ai ishte caktuar dhe leximin e mjetit tek i cili ai sapo është caktuar);

e) kohën e çdo ndryshimi të mjetit.

Në kushtet normale të ruajtjes, regjistrimet duhet të mbeten qartësisht të lexueshme gjatë të paktën një viti.

2. Kapaciteti minimal i regjistrimit të fletëve, cilado qoftë forma e tyre, duhet të jetë 24 orë.

Nëse shumë disqe lidhen midis tyre me qëllim rritjen e kapacitetit të regjistrimit të vazhdueshëm të realizuar pa ndërhyrjen e personelit, lidhjet midis disqeve të ndryshme duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të mos ketë ndërprerje ose mbulim të regjistrimeve gjatë transferimit nga një disk te tjetri.

B. ZONAT E REGJISTRIMIT DHE SHKALLËZIMI I TYRE

1. Fletët e regjistrimit përmbajnë zonat e mëposhtme të regjistrimit:

- një zonë të rezervuar ekskluzivisht për të dhënat në lidhje me shpejtësinë;

- një zonë të rezervuar ekskluzivisht për të dhënat në lidhje me distancën e përshkuar;

- një ose disa zona për të dhënat në lidhje me kohën e drejtimit, periudhat e tjera të punës dhe disponueshmërisë, të ndërprerjeve të punës dhe periudhave të pushimeve të drejtuesve të mjeteve.

2. Zona për regjistrimin e shpejtësisë duhet të jetë e ndarë në pjesë prej 20 km/orë ose më pak. Shpejtësia korresponduese për secilin mbishkrim në shkallë duhet të tregohet në shifra kundrejt atij mbishkrimi. Simboli km/orë duhet të tregohet të paktën një herë brenda zonës. Mbishkrimi i fundit në shkallë duhet të përputhet me kufirin e sipërm të kufirit të matjes.

3. Zona për regjistrimin e distancës së përshkuar duhet të vendoset në atë mënyrë që numri i kilometrave të përshkuara të lexohet pa vështirësi.

4. Zona ose zonat për regjistrimin e periudhave të përmendura në pikën 1, duhet të shënohen në atë mënyrë që të jetë e mundur të dallohen qartësisht periudhat e ndryshme kohore.

C. INFORMACIONI QË DUHET SHTYPUR NË FLETËT E REGJISTRIMIT

Çdo fletë duhet të përmbajë, në format të printuar, informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën ose markën e fabrikës së prodhuesit;

- markën e miratuar të modelit të fletës;

- markën e miratuar të llojit ose llojeve të pajisjeve të kontrollit në të cilat mund të përdoret fleta;

- kufirin e sipërm të kufirit të matjes së shpejtësisë, të shtypur në km/orë.

Nga kërkesat minimale shtesë, çdo fletë duhet të përmbajë të shtypur të paktën një shkallë kohe të graduar në mënyrë që koha të lexohet direkt në intervale prej 15 min ndërsa çdo interval prej 5 min të mund të përcaktohet pa vështirësi.

D. HAPËSIRA E LIRË PËR MBISHKRIMET ME DORË

Një hapësirë e lirë duhet të parashikohet në fletët, në mënyrë që drejtuesit të mund të shkruajnë detajet e mëposhtme:

- mbiemrin dhe emrin e drejtuesit;

- datën dhe vendin e fillimit të përdorimit të fletës, si dhe datën dhe vendin kur përfundon përdorimi i fletës;

- numrin ose numrat e regjistrimit të mjetit ose të mjeteve në të cilat drejtuesi është caktuar gjatë përdorimit të fletëve.

- leximet e kilometrazhit të mjetit(ëve) në të cilat drejtuesi është caktuar gjatë përdorimit të fletës;

- orën në të cilën ndodh çdo ndryshim i mjetit.

V. INSTALIMI I PAJISJES SË KONTROLLIT

A. TË PËRGJITHSHME

1. Pajisjet e kontrollit duhet të vendosen në mjete, në mënyrë të tillë që drejtuesi të ketë një pamje të qartë nga vendi i tij, të treguesit të shpejtësisë, regjistruerit të distancës dhe orës, dhe në të njëjtën kohë të gjitha pjesët e këtyre treguesve, përfshirë ato të drejtimit, duhet të jenë të mbrojtura ndaj çdo dëmtimi të paparashikuar.

2. Duhet të jetë e mundur që të përshtatet konstantja e pajisjes së kontrollit me koeficientin karakteristik të mjetit me anë të një pajisjeje të quajtur përshtatës.

Mjetet me dy ose më shumë akse të pasme aktive duhet të pajisen me një pajisje ndërruese me anë të së cilës këto raporte të ndryshme të mund të vendosen automatikisht në një linjë me raportin për të cilin pajisja e kontrollit është përshtatur me mjetin.

3. Pas verifikimit të pajisjes së kontrollit gjatë instalimit, një pllakë instalimi do të fiksohet në mjet, pranë pajisjes ose brenda vetë pajisjes, në mënyrë që të jetë qartësisht e dukshme. Pas çdo inspektimi nga një mekanik ose ofiçinë të miratuar që kërkon një ndryshim në vetë instalimin, duhet të vendoset një pllakë e re që zëvendëson pllakën e mëparshme.

4. Minimalisht, pllaka duhet të përmbajë detajet e mëposhtme:

- emrin, adresën ose markën e mekanikut apo ofiçinës së miratuar;

- koeficientin karakteristik të mjetit, në formën “ $\ddot{e}=\dots rrot/km$ ” “ $\ddot{e}=\dots imp/km$ ”;

- rrethin efektiv të gomave të rrotave në formën “ $1=\dots mm$ ”;

- datën në të cilën është përcaktuar koeficienti karakteristik i mjetit dhe përmasat e rrethit efektiv të gomave të rrotave.

B. VULOSJA

Duhet të vulosen pjesët e mëposhtme:

a) pllaka e instalimit, vetëm nëse është vendosur në mënyrë të tillë që nuk mund të hiqet pa dëmtuar mbishkrimet;

b) ekstremitetet e lidhjes midis vetë pajisjes së kontrollit dhe mjetit;

c) përshtatësin dhe lidhjen e tij me rrjetin;

d) mekanizmin ndërrues për mjetet me dy ose më shumë diferencialë;

e) lidhjet e përshtatësit dhe mekanizmit ndërrues me pjesën tjetër të pajisjes së kontrollit;

f) mbulesat e kërkuara sipas kapitullit III, A, 7 (b)

Në raste të veçanta, mund të kërkohej vulosje të tjera për miratimin e llojit të pajisjes së kontrollit dhe duhet të bëhet një shënim mbi vendosjen e këtyre vulave në certifikatën e miratimit.

Në raste urgjence, mund të hiqen vetëm vulat e përmendura në b), c) dhe e); për çdo rast të heqjes së këtyre vulave, duhet të përgatitet një deklaratë me shkrim, ku të jepen arsyet e një veprimi të tillë dhe kjo do t'i mundësohet autoritetit kompetent.

VI. KONTROLLET DHE INSPEKTIMET

Palët Kontraktuese do të caktojnë organizmat që do të kryejnë kontrollet dhe inspektimet.

1. Certifikimi i instrumenteve të reja ose të riparuar

Çdo pajisje individuale e re ose e riparuar, do të certifikohet lidhur me mirëfunktionimin dhe saktësinë e leximeve dhe regjistrimeve të saj, brenda kufizimeve të vendosura në kapitullin III, F, 1, nëpërmjet vulosjes, në përputhje me kapitullin V, B, f).

Për këtë qëllim, Palët Kontraktuese mund të parashikojnë një verifikim fillestar, që konsistohet nga një kontroll dhe konfirmim i konformitetit të një pajisjeje të re ose të riparuar me modelin e miratimit tip dhe/ose me kërkesat e këtij aneksi dhe shtojcat e tij ose mund t'ia delegojnë të drejtën për të certifikuar prodhuesve apo agjentëve të tyre të autorizuar.

2. Instalimi

Kur i përshtatet një mjeti, pajisja e kontrollit dhe i tërë instalimi duhet të përputhet me dispozitat

lidhur me tolerancat maksimale, të vendosura në kapitullin III, F, 2.

Testet e inspektimit do të kryhen nga mekaniku ose ofiçina e miratuar nën përgjegjësinë e tij ose të saj.

3. Inspektimet periodike

a) Inspektimet periodike të pajisjes së kontrollit të përshtatur në mjete do të kryhen të paktën çdo dy vjet dhe mund të kryhen me testet e vlefshmërisë në rrugë të mjeteve.

Këto inspektime do të përfshijnë kontrollet mëposhtme:

- nëse pajisja funksionon siç duhet apo jo;
- nëse pajisja mban markën e miratimit tip;
- nëse është ngjitur pllaka e instalimit;
- nëse vulat mbi pajisjen e kontrollit mbi pjesë të tjera të instalimit janë të paprekura;
- rrethin efektiv të gomave.

b) Kontrolli i respektimit të dispozitave të kapitullit III, F, 3 lidhur me tolerancat maksimale në përdorim, do të kryhet të paktën një herë në gjashtë vjet, megjithatë çdo Palë Kontraktuese mund të parashikojnë një afat më të shkurtër për inspektime të tilla, në lidhje me mjetet e regjistruara në territorin e saj. Këto inspektime duhet të përfshijnë zëvendësimin e pllakës së instalimit.

4. Matja e gabimeve

Matja e gabimeve në instalim dhe në përdorim do të kryhet sipas kushteve të mëposhtme që duhet të konsiderohen si kushte standarde të provës:

- mjetet bosh, në kushtet normale të ecjes;
- presioni i gomave në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;
- konsumimi i gomave në kufijtë e pranuar nga ligjet në fuqi;
- lëvizja e mjetit: ai duhet të zhvendoset nga vetë motori i tij në linjë të drejtë, në një plan, me një shpejtësi 50 ± 5 km/orë, me kusht që të ketë një saktësi të krahasueshme. Testi mund të kryhet gjithashtu në një bankëprovë të përshtatshme.

ANEKS

SHTOJCA 2

MARKA DHE CERTIFIKATA E MIRATIMIT

1. Marka e miratimit do të përbëhet nga:

një drejtkëndësh, brenda të cilit do të vendoset germa AE@ e pasuar nga një numër i përcaktuar për vendin që ka lëshuar miratimin, në përputhje me shenjat konvencionale si më poshtë vijon:

Gjermania 1

Franca 2

Italia 3

Holanda 4

Suedia 5

Belgjika 6

Republika Çeke 8

Spanja 9

Jugosllavia 10

Mbretëria e Bashkuar 11

Austria 12

Luksemburgu 13

Norvegjia 16

Danimarka 18

Rumania 19

Polonia 20

Portugalia 21

Federata Ruse 22

Greqia 23

Irlanda 24

Kroacia 25

Silovenia 26
Slovakia 27
Bjellorusia 28
Estonia 29
Moldavia 30
Bosnjë-Hercegovina 31
Letonia 32

Numrat vijues do t'i caktohen:

i) vendeve Palë Kontraktuese në Marrëveshjen e 1958-ës, në lidhje me miratimin e Rregullave Uniforme të Miratimit dhe Njohjen Reciproke të Miratimit për Pajisjet dhe Pjesët e Mjeteve Motorike; të njëjtët numra siç i janë caktuar atyre vendeve sipas asaj Marrëveshjeje; dhe

ii) vendeve jo Palë Kontraktuese në Marrëveshjen e 1958, sipas radhës kronologjike, në bazë të së cilës ato ratifikojnë ose pranojnë këtë Marrëveshje dhe një numër miratimi që përputhet me numrin e certifikatës së miratimit, të hartuar për prototipin e pajisjes së kontrollit ose fletës së regjistrimit, e vendosur në çdo pikë, brenda kufijve të këtij drejtkëndëshi.

Shënim. Me qëllim për të siguruar në të ardhmen përputhjen ndërmjet shenjave konvencionale në Marrëveshjen e 1958 dhe ato të vendosura në Marrëveshjen e AETR, Palëve të reja Kontraktuese do t'u jepet i njëjti numër në të dyja marrëveshjet.

2. Marka e miratimit do të shfaqet në pllakën përshkruese të secilit set të pajisjes së kontrollit dhe në secilën fletë të regjistrimit. Ajo duhet të jetë e pashlyeshme dhe qartësisht e lexueshme.

3. Përmasat e markës së miratimit të hartuar më poshtë shprehen në milimetra, duke qenë këto përmasat më minimale. Duhet të ruhet raporti ndërmjet përmasave.

II. Certifikata e miratimit

Një Palë Kontraktuese që ka dhënë miratimin do t'i lëshojë aplikantit një certifikatë miratimi, modeli i së cilës jepet më poshtë. Kur njoftohen Palët e tjera Kontraktuese për miratimet e lëshuara ose nëse lind nevoja për tërheqjet, një Palë Kontraktuese do të përdorë kopje të asaj certifikate.

Certifikatë miratimi

Emri i administratës kompetente.....

Njoftim në lidhje me ¹.

- miratimin e një lloji të pajisjes së kontrollit;
- tërheqjen e miratimit të një lloji të pajisjes së kontrollit;
- miratimin e një modeli të fletës së regjistrimit;
- tërheqjen e miratimit të një flete të regjistrimit.

Nr.i miratimit.....

1. Marka e fabrikës.....

2. Emri i llojit të modelit.....

3. Emri i prodhuesit.....

5. Dorëzuar për miratim më.....

6. Testuar në.....

7. Data e miratimit.....

8. Data e tërheqjes së miratimit.....

10. Lloji ose llojet e pajisjet së kontrollit në të cilën fleta është vendosur të përdoret.....

11. Vendi.....

12. Data.....

13. Dokumente shpjeguese bashkëlidhur.....

14. Vërejtje.....

.....

(Nënshkrimi)

SHTOJCË
LIBREZA INDIVIDUALE E KONTROLLIT

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
KUJTESË E DISPOZITAVE LIGJORE

1. Është e dëshirueshme që librezat e kontrollit individuale të përmbajë një kujtesë të dispozitave themelore që duhen respektuar nga pjesëtarët e ekuipazhit.

Numërtimi i librezës

2. Libreza e kontrollit individuale do të numërtohet me shpim ose stampim.

Formati i librezës

3. Libreza e kontrollit individuale do të ketë standardin A6 (105x148 mm) ose një format më të madh.

Firmosja e librezës

4. Firma e pjesëtarëve të ekipit do të figurojë njëkohësisht mbi fletën e përditshme dhe mbi raportin javor. Firma e punëdhënësit do të figurojë në raportin javor.

Përmbajtja e librezës

5. Subjekt i dispozitave të paragrafit 7 më poshtë, librezat e kontrollit individual do të jetë në përputhje me modelin bashkëlidhur; ajo do të përmbajë:

a) një fletë mbuluese;

b) udhëzimet për përmbajtjen e librezës;

c) fletët ditore;

d) një shembull i gatshëm për mënyrën e mbushjes së fletës ditore;

e) raportet javore.

6. Çdo Palë Kontraktuese, për librezat e dorëzuara në territorin e saj, do të caktojë mënyrën sipas së cilës anëtari i ekuipazhit duhet të plotësojë periudhat e aktivitetit të tij profesional të ndryshme nga ato të periudhave të drejtimit të mjetit.

Për këtë qëllim, çdo Palë Kontraktuese mund të zgjedhë një nga mënyrat vijuese:

a) periudhat e veprimtarive profesionale të tjera nga drejtimi i mjetit, do të paraqiten me simbolin pa dallim brenda periudhës së lejuar të punës efektive dhe periudhave të tjera të shërbimit;

b) periudhat e veprimtarive profesionale, përveç atë të drejtimit të mjetit, do të paraqiten duke i dalluar:

- nën simbolin R punët efektive të tjera nga drejtimi i mjetit;

- nën simbolin R periudhat e shërbimit, të ndryshme nga ato të përmendura me simbolet

R dhe

7. Çdo Palë Kontraktuese mund të përcaktojë për librezën individuale të kontrollit të shpërndarë në territorin e saj:

a) hartimin në një bandë të vetme të diagramës që figuron në fletën e përditshme, që përmban një periudhë nga 0 në 24 orë;

b) mbajtjen e fletës së përditshme në më shumë se një kopje;

c) tregues ose rubrika shtesë ose variante, me kusht që paraqitja e përgjithshme e librezës së kontrollit individual të mos modifikohet dhe që numrat ose shkronjat e mëdha, si dhe rubrikat që figurojnë në modelin që vijon të mos ndryshohen;

d) të gjitha modifikimet dhe treguesit plotësues si dispozitat në ndjekje të paragrafit 6 të mësipërm, mund të bëjnë të domosdoshme në lidhje me simbolet korresponduese të rubrikës 7 7.a 14 dhe 14.a të fletës ditore;

e) të mos plotësohen kutitë si rubrika Ha, Hb dhe/ose i të raportit javor;

f) të shkëputen fletët ditore që datojnë më shumë se dy javë.

MODELI I LIBREZËS SË KONTROLLIT INDIVIDUAL
Fleta e mbulimit (ballore)

I. LIBREZA E KONTROLLIT INDIVIDUAL PËR ANËTARËT E EKUIPAZHIT TË TRANSPORTIT RRUGOR	
II. Vendi.....	
III. Data e parë e përdorimit të librezës.....	200
IV. Data e fundit e përdorimit të librezës.....	200
V. Emri,mbiemri (at), data e lindjes dhe adresa e mbajtësit të librezës.....	
.....	
.....	
VI. Emri,adresa,numri i telefonit dhe vula (n.q.s ka) e sipërmarrjes	
.....	
.....	
.....	
Libreza nr.....	

b) Udhëzime

Udhëzime për përdorimin e librezës së kontrollit individual

1. Kjo librezë e kontrollit individual është shpërndarë në përputhje me (tregoni ligjin ose rregulloren përkatëse)

.....

Në vëmendje të sipërmarrjeve

2. Pas mbushjes së rubrikave V dhe VI në fletën ballore, dorëzoni një librezë për çdo pjesëtar të ekuipazhit në përputhje me ligjet dhe rregulloren sipas pikës 1 më lart.

3. Mbani në një regjistër emrat e personave që u keni dorëzuar librezën, duke treguar numrin e serisë për çdo librezë dhe datën e dorëzimit. Kërkoni nënshkrimin e mbajtësit mbi këtë regjistër.

4. Jepini mbajtësit të librezës çdo tregues të dobishëm për përdorimin e saktë të librezës.

5. Shqyrtoni çdo javë ose, sipas rastit, më shpejt, çdo fletë ditore dhe raport javor. Nënshkruani raportin javor.

6. Tërhiqni librezat e kontrollit të përdorura, duke pasur parasysh afatet e caktuara në paragrafin 9 më pas dhe mbajini ato për një periudhë të paktën prej dymbëdhjetë muajsh në dispozicion të punonjësve të ngarkuar me kontrollin. Shënoni në regjistrin e përcaktuar në paragrafin 3 më lart datën e fletës së fundit javore.

Në vëmendje të anëtarëve të ekuipazhit

7. Kjo librezë kontrolli është personale. Ju duhet ta keni atë me vete kur jeni në shërbim dhe t'ua paraqisni autoriteteve të kontrollit që e kërkojnë atë. Jepjani atë punëdhënësit tuaj kur largoheni nga sipërmarrja.

8. Paraqitjani punëdhënësit tuaj çdo javë ose më herët për të mundësuar verifikimin e shënimeve tuaja dhe firmosen e raportit javor.

9. Kur librezat të ketë përfunduar, mbajeni atë për dy javë me qëllim që t'ua paraqisni në çdo moment punonjësve të kontrollit. Pastaj, sa më shpejt që të jetë e mundur, dorëzoni punëdhënësit tuaj. Ruani një kopje të raportit javor.

Mbulesa

10. Verifikoni nëse emri juaj, mbiemri, datëlindja dhe adresa janë regjistruar saktësisht (rubrika V).

11. Regjistroni datën në të cilën ju përdorni librezën e kontrollit për herë të parë (rubrika III).

12. Pas përdorimit, regjistroni datën e fundit të përdorimit (rubrika IV).

13. Plotësoni një fletë ditore për çdo ditë gjatë së cilës ju keni punuar si anëtar ekuipazhi.
14. Shënoni në kutinë 2 numrin e regjistrimit të çdo automjeti të përdorur gjatë ditës.
15. Simbolet e përdorura kanë kuptimin e mëposhtëm:
Zgjatjen totale të periudhës së pushimit ditor përpara marrjes së shërbimit.
Periudhën e pushimit ditor.
Periudhën jashtë shërbimit.
Periudhën e drejtimit të automjetit.

Varianti 1)*/

Periudhën e veprimtarive profesionale të tjera nga ato të udhëtimit.

Varianti 2)*/

Punët efektive të tjera nga ato të udhëtimit.

Periudhat e shërbimit të ndryshme nga ato të nënvizuara me simbolet dhe

16. Shënoni periudhën tuaj të pushimit ditor: (simboli); periudhën jashtë shërbimit (simbol dhe kohën në të cilën ju jeni të përfshirë në aktivitete të përfaqësuara nga simbolet: (varianti i parë i rubrikave 6 dhe 7 varianti i dytë i rubrikave 6, 7 7.a , duke hequr një vijë horizontale nën orën korresponduese, duke i parë simbolet korresponduese dhe duke i lidhur vijat horizontale me vija vertikale. Atje do të bëhet një linjë e vazhdueshme mbi të gjithë gjatësinë e shiritit (shiko shembullin në librezë).

17. Shënimet mund të bëhen në fillim dhe në fund të çdo periudhe, për të cilën ato raportohen.

18. Në kutinë 16 “Vërejtje” shënoni emrin e shoferit të dytë, në qoftë se ka. Përveç kësaj kjo kuti mund të përdoret për të sqaruar çdo shkelje të mundshme të dispozitave ose për të rregulluar treguesit që figurojnë në kutitë e tjera (shiko paragrafin 25). Punëdhënësi ose punonjësit e ngarkuar të kontrollit mund të regjistrojnë aty vërejtjet e tyre në këtë kuti.²

19. Në kutinë 12 , shënoni numrin e orëve të pushimit të pandërprerë (pushimin ditor) të marrë menjëherë përpara se të fillojë shërbimi. Nëse kjo periudhë fillon në një ditë dhe mbaron në ditën në vazhdim shifrat do të përfaqësojnë totalin e periudhës së pushimit nga fundi i ditës së mëparshme dhe periudhën e pushimit në ditën në vijim, në të cilën plotësohet fleta.

20. Përpara nisjes, shënoni në kutinë 11 “Fillimi i shërbimit” kilometrazhin sipas treguesit kilometrik; në fund të shërbimit regjistroni në kutinë 11 “Fund i shërbimit” kilometrazhin e ri dhe shënoni përshkrimin e përgjithshëm.

21. Nënshkruani fletën çdo ditë.

² Varianti i përdorur ose zgjidhja e bërë do të varet nga Palët Kontraktuese në përputhje me paragrafin 6 të dispozitave të përgjithshme. Vetëm varianti i zgjedhur kështu do të paraqitet në librezën e kontrollit individual.

Raporti vjetor

22. Ky raport do të hartohet në fund të çdo periudhe javore që përmban hartimin e një ose më shumë fletëve ditore. Për ditët në të cilën ju ishit në shërbim pa u bërë një pjesëtar i ekuipazhit, pra kur nuk ka pasur vend për hartimin e fletës ditore, shënoni shifrën “O” në kutinë G dhe për kohëzgjatjen e periudhave të shërbimit në kutitë Ha dhe Hb; nëse ju nuk keni ushtruar një nga aktivitetet e parashikuara, regjistroni shifrën “O” në rastin e përshtatshëm. Për ditët kur ju nuk keni qenë në shërbim regjistroni shifrën “O” në kutitë G, Ha dhe Hb dhe shtoni një shpjegim të tillë si “me pushim” ose “ditë pushimi”.

23. Shënoni në kutitë F dhe G shifrat që figurojnë në kutitë 12 dhe 13 të ditës të fletëve ditore korresponduese.

Udhëzimi shtesë zbatohet për rastet kur legjislacioni kombëtar detyron pjesëtarët e ekuipazhit të mbajnë një libër kontrolli individual të kontrollit vetëm për transportin ndërkombëtar.

24. Përpara sipërmarrjes së një transporti ndërkombëtar, shënoni në kutitë 12 dhe 13 në fletën ditore për të shtatë ditët që vijojnë atë të fillimit të këtij transporti; shënimet lidhur me kohëzgjatjen totale të pushimeve të pandërprera gjatë marrjes së shërbimit dhe periudhat e drejtimit ditor të mjetit, për të plotësuar një raport javor për këto shtatë ditë.

Shënime të përgjithshme

25. Në librezë nuk mund të bëhen as fshirje, as korrektive dhe as shtesa: gabimet, madje dhe vetëm në formë, mund të korrektohen në rubrikën “Vërejtje” (kutia 16).

26. Asnjë fletë nuk duhet prishur.

27. Të gjitha shënimet të bëhen me bojë.

Shënim 1. Në praktikë, kutitë 10 dhe 10.a do të mbushen së bashku në të njëjtën fletë ditore vetëm në rastet kur një pjesëtar ekuipazhi ka kryer një transport udhëtarësh dhe një transport mallrash në të njëjtën ditë. Në kutinë 10.a (plotësuar vetëm nga pjesëtarët e ekuipazhit të destinuar për transportin e udhëtarëve) do të regjistrohet “10.h” ose “11.h”, sipas sistemit të pushimit ditor që zbatohet nga anëtari i ekuipazhit.

Shënim 2. Brenda kutisë 12, fakti për të treguar 12 orë kohëzgjatje totale të pushimit të pandërprerë që vijon marrjen e shërbimit, tregon që shoferi ka mbaruar punën e tij në orën 19 të një nate më parë. Pra duke shtuar 7 orët e treguara në kutinë 4,5 orët nëpërmjet orës 19 dhe 24 të një dite më parë, arrihet në një total prej 12 orësh.

(e) Raporti javor

A.		Ismi (at) dhe mbiemri (at) e pjesëtarit (ëve) të ekipazhit									
B.		RAPORTI JAVOR									
C.		Nga..... për..... 200 të përfshira									
D.		Ditët e periudhës javore									
E.		Fleta ditore nr.									
F.											
Orët e zëna me punë	G										
	H	<input checked="" type="checkbox"/>									
	Hb										
	G + Ha + Hb										
K.		Varejtje.....									
L.		Data e pushimit javor vijues.....									
M.		Firma e pjesëtarit të ekipazhit.....									
N.		Firma e punëdhënësit.....									
Libreza Nr.										

Protokoll i nënshkrimit

Kur nënshkruan Marrëveshjen Evropiane në lidhje me punën e ekipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor, nënshkruerit të autorizuar posaçërisht për këtë ranë dakord për sa më poshtë:

Palët Kontraktuese deklarojnë që kjo Marrëveshje nuk paragjykon dispozitat që, në rast se duhet, mund të hartohen më vonë për sa i përket kohëzgjatjes dhe shpërndarjes së punës.

ad neni 4 i kësaj Marrëveshjeje

Dispozitat e nenit 4, paragrafi 1, nuk do të interpretohen sikur e bëjnë të zbatueshëm jashtë shtetit në të cilin mjeti që kryen transportin është regjistruar, çdo ndalim të trafikut në ditë të veçanta ose orë të veçanta që mund të aplikohen në atë vend për kategori të veçanta të mjeteve. Dispozitat e nenit 4, paragrafi 2 nuk do të interpretohen sikur e ndalojnë një Palë Kontraktuese nga vënia në zbatim në territorin e saj të dispozitave ligjore dhe rregulloreve të

saj të brendshme të cilat ndalojnë kategori të veçanta të trafikut të mjeteve në ditë të veçanta ose orë të veçanta.

Çdo Palë Kontraktuese, e cila, duke qenë palë në një marrëveshje të veçantë siç përmendet në nenin 4, paragrafi 2 të kësaj Marrëveshjeje, autorizon kryerjen e transportit ndërkombëtar rrugor me mjete të regjistruara në territorin e një shteti, i cili është palë e kësaj Marrëveshjeje, por nuk është palë në Marrëveshjen e veçantë në fjalë, në një udhëtim që fillon dhe mbaron në territoret e palëve të marrëveshjes së veçantë në fjalë mund të kushtëzohet lidhjen e marrëveshjeve bilaterale ose multilaterale që autorizojnë se për kryerjen e një transporti të tillë në territoret e shteteve palë në marrëveshjen e veçantë në fjalë, ekuipazhet e përfshira në to të përmbushin dispozitat e marrëveshjes së veçantë në fjalë.

ad neni 12 i Marrëveshjes

Nënshkruesit marrin përsipër të diskutojnë pasi Marrëveshja të ketë hyrë në fuqi me shtesën këtu, përmes një amendamenti, të një dispozite të parashikuar për përdorimin e një pajisjeje kontrolli të tipit të miratuar, e cila kur të vendosej në mjet të zëvendësojë sa të ishte e mundur më shumë librin individual të kontrollit.

ad neni 14 i Marrëveshjes

Palët Kontraktuese pranojnë se do të ishte e dëshirueshme:

- që secila Palë Kontraktuese të miratojë masat e nevojshme që ta lejojnë atë të fillojë ndjekjen ligjore për shkeljen e dispozitave të Marrëveshjes jo vetëm kur shkeljet kryhen në territorin e saj, por edhe kur ato kryhen në territorin e një shteti tjetër gjatë kryerjes së një transporti ndërkombëtar rrugor nga një mjet të regjistruar nga ajo Palë Kontraktuese;

- që ato t'i sigurojnë njëra-tjetrës mbështetje për qëllimin e vënies së gjobave për shkeljet e kryera.

ad aneksi i Marrëveshjes

Pa paragjykuar paragrafin 4 të dispozitave të përgjithshme të aneksit të kësaj Marrëveshjeje, Zvicra mund të përjashtohet nga kërkesa që punëdhënësit duhet të nënshkruajnë raportet javore në librin e kontrollit individual.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar posaçërisht, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Gjenevë, këtë ditë të parë të korrikut të njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetës, në një origjinal të vetëm, në gjuhët angleze dhe franceze, të dyja tekstet me vlerë të barabartë.

AMENDAMENTI 4

Përmbajtja e nenit 12-Masat për zbatimin e Marrëveshjes zëvendësohet nga teksti i mëposhtëm:

Neni 12

Masat e zbatimit të Marrëveshjes

1. Secila Palë Kontraktuese do të miratojë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar respektimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, në veçanti nëpërmjet një niveli të mjaftueshëm të kontrolleve në rrugë dhe kontrolleve të kryera në mjediset e ndërmarrjeve çdo vit duke mbuluar një pjesë të madhe dhe përfaqësuese të drejtuesve të mjeteve, ndërmarrjeve dhe mjeteve të të gjitha kategorive të transportit që përfshihen brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje.

a) Administratat kompetente të Palëve Kontraktuese do të organizojnë kontrolle në mënyrë që:

- gjatë çdo viti kalendarik do të kontrollohet një minimum prej 1% i ditëve të punës së

drejtuesve të mjeteve për të cilët zbatohet kjo Marrëveshje;

- të paktën 15% e numrit të përgjithshëm të ditëve të punës të kontrolluara do të kontrollohen në rrugë dhe të paktën 25% në mjediset e ndërmarrjeve.

b) Elementet e kontrolleve në rrugë do të përfshijnë:

- periudhat ditore të drejtimit të mjetit, pushimet dhe periudhat ditore të pushimit dhe nëse ka parregullsi të dukshme, fletët e regjistrimit të ditëve të mëparshme, të cilat do të jenë në mjet;

- periudhat e pushimit të javës së fundit, nëse është e përshtatshme;

- funksionimin e saktë të pajisjes së kontrollit.

Këto kontrole do të kryhen pa diskriminuar mjetet dhe drejtuesit e mjeteve pavarësisht nëse janë apo jo rezident.

c) Elementet e kontrolleve në mjediset e sipërmarrjeve do të përfshijnë, përveç elementeve subjekt të kontrolleve në rrugë, në përputhje me nenin 10, paragrafi 3:

- periudhat javore të pushimit dhe periudhat e drejtimit të mjetit ndërmjet këtyre periudhave të pushimit;

- limitet dyjavore të orëve të drejtimit të mjetit;

- kompensimin për periudhat javore dhe ditore të pushimit të reduktuara në përputhje me nenin 8, paragrafi 1 dhe 3.

- përdorimin e fletëve të regjistrimit dhe/ose organizimin e kohës së punës së drejtuesve të mjeteve.

2. Në kuadër të ndihmës së ndërsjellë, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do t'i dërgojnë rregullisht njëra-tjetrës të gjithë informacionin e mundshëm në lidhje me:

- shkeljet e kësaj Marrëveshjeje të kryera nga personat jorezidentë dhe çdo gjobë të vendosur për shkelje të tilla;

- gjobat e vendosura nga një Palë Kontraktuese ndaj rezidentëve të saj për shkelje të tilla të kryera në territorin e Palëve të tjera Kontraktuese.

Në rast të shkeljeve serioze, një informacion i tillë do të përfshijë gjobën e vendosur.

3. Nëse rezultatet e një kontrolli në rrugë ndaj një drejtuesi të një mjeti të regjistruar në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese do të japin prova për të besuar se shkeljet janë kryer, por nuk mund të zbulohen gjatë kontrollit për shkak të mungesës së të dhënave të nevojshme, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të interesuara do të ndihmojnë njëra-tjetrën për të qartësuar situatën. Në rastet kur, për këtë qëllim, Pala Kontraktuese kompetente kryen një kontroll në mjediset e sipërmarrjes, rezultatet e këtij kontrolli do t'i komunikohen palës tjetër të interesuar.

4. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për organizimin e kontrolleve rrugore të bashkërenduara.

5. Komisioni Ekonomik për Evropën e Kombeve të Bashkuara do të përgatisë një raport çdo dy vjet për zbatimin e paragrafit 1 të nenit në fjalë nga ana e shteteve Palë Kontraktuese.

Hyn në fuqi më 27 shkurt 2004.